



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0210

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

NP "....", P, të cilin e përfaqëson L R, avokat, P

kundër

E paditura/Ankuesja

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-21-0021 të datës 06 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesat refuzohen si të pa bazuara.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-21-0021 të datës 06 mars 2021.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 14 gusht 2013, përmes postës paditësi e dorëzoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ017-0020, të datës 19 korrik 2013, me të cilin kërkesa e paditësit e datës 04 shtator 2006 për kompensimin e shumës prej 4.525,95 euro lidhur me borxhin e pretenduar në bazë të faturave të paguara, është refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se në bazë të nenit 379 të LMD-së, kërkesa është parashkruar, duke konstatuar se paditësi nuk ka bërë asnjë kërkesë për ekzekutim të vendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë I.V.II.1468 të datës 06 dhjetor 1995. Në ankesë paditësi ka pohuar se ai ka të drejtë në kompensimin e të hollave në shumë prej 4.535,95 euro në emër të borxhit të pa paguar pasi NSH-ja për këtë shumë i ka mbetur borxh, duke qenë se ajo nuk i ka dorëzuar asnjëherë 26.470 copë tullash makinerish, të cilat ishin paguar. Tutje paditësi në ankesë pohon se pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë ka paraqitur kërkesë për lejim të ekzekutimit, në bazë të dokumentit të besueshëm- faturës së paguar, është lejuar ky propozim për ekzekutim me Aktvendimin IV.II nr.1468/95 të datës 20.11.1995, ndaj këtij Aktvendimi e paditura ka paraqitur kundërshtim dhe pastaj kjo gjykatë kërkesën për ekzekutim e ka konsideruar padi. Pastaj ai pohon në bazë të sajë është zhvilluar procedurë gjyqësore dhe me Aktgjykimin IV.P.1468/95 të datës 06.12.1995, shfuqizohet vendimi i kësaj gjykate për lejimin e ekzekutimit nr.2693/95 i datës 05.10.1995, dhe aprovohet kërkesa e paditësit duke e detyruar të paditurën GIP "P" nga Pi t'i dorëzojë 26.470 copë tullash makinerish tek paditësi, si dhe ti kompensojë paditësit shpenzimet gjyqësore prej 180,00euro. Tutje paditësi pohon se ndaj këtij Aktgjykimi e paditura ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Lartë Tregtare në Beograd, mirëpo asnjëherë deri më tani nuk është vendosur lidhur me këtë ankesë. Paditësi pretendon se Autoriteti i Likuidimit pa ndonjë bazë ligjore e ka refuzuar kërkesën e tij për kompensim me arsyetimin se kërkesa është parashkruar.

Me datë 29 dhjetor 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën ajo ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të

rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht, duke kërkuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar. Tutje AKP-ja pohon se nuk është kontestuese se paditësi e ka një Aktgjykim të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.P.nr.396/96 të datës 28 tetor 1996, mirëpo paditësi nuk ka ndërmarrë masat e duhura për ta realizuar kërkesën e tij të vitit 1995, duke pohuar se ai nuk ka arritur ta ndërpresë afatin e parashkrimit prej 10 viteve, dhe në kuptimin e nenit 36.2 pika 1 e Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kjo kërkesë është refuzuar si e pa bazuar.

Me datë 26 mars 2018, paditësi e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në mbrojtje në ankesë në të cilën ai i ka përsëritur pretendimet e tij të cekura në ankesë, duke pohuar po ashtu se nuk ka parashkrim të kërkesës, pasi që dihen rrethanat dhe koha e luftës dhe ai ishte i detyruar të largohet nga Kosova për të jetuar 2 vite në Gjermani.

Me datë 12 prill 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë kundërpërgjigjen në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e saja të paraqitura në mbrojtjen në ankesë, duke pohuar se paditësi nuk ka arritur të argumentojë kërkesën e tij dhe t'i kundërshtojë argumentet ligjore të cekura në vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 13 maj 2020, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-13-1545, e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi me datë 22.09.1995, e ka paraqitur një kërkesë për lejimin e përmbarimit dhe kompensimin apo dorëzimin e 26.470 copë tullash makinerish, bazuar në faturat e paguara, ndërsa Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin e saj nr.IV.1468/95 të datës 06.12.1995, këtë kërkesë e konsideron si padi dhe ajo është aprovuar, duke e obliguar të paditurën t'i dorëzojë 26.470 copë tullash makinerish dhe të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 180 dinarë të atëhershëm. Tutje Shkalla e I-rë të DHPGJS-së konstaton se ndaj këtij Aktgjykimi e paditura ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Lartë Ekonomike në Beograd, me datë 16.01.1996, mirëpo çështja nuk

është zgjidhur dhe palët nuk kanë një Aktgjykim të formës së prerë. Tutje Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka konstatuar se në bazë të nenit 361 paragrafi 1 i LMD-së, kërkesat parashkruhen në afat prej 10 vitesh nëse janë vërtetuar me vendim të formës së prerë. Në këtë rast e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar në të holla për periudhën 28 korrik 1994, në emër të faturave të paguara, është ligjërisht e vjetërsuar pas 10 viteve, respektivisht me datë 28 korrik 2004.

Me datë 26 qershor 2020, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-13-1545 të datës 13 maj 2020, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose çështja të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se gjykata e shkallës së I-rë nuk i ka marrë parasysh pretendimet e paditësit se me Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.nr.1468/95 të datës 06.12.1995, është aprovuar padia si e bazuar dhe e paditura ishte e detyruar të dorëzojë 26.470 copë tullash, të cilat ishin paguar por që nuk ishin dorëzuar nga e paditura. Ky Aktgjykim ishte ankimuar nga e paditura, ndërsa Gjykata e Lartë Ekonomike në Beograd deri më tani nuk ka nxjerrë asnjë vendim, prandaj në bazë të nenit 369 të LMD-së parashkrimi është ndërprerë me paraqitjen e padisë dhe nuk bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës. Në ankesë paditësi pretendon se konstatimet e Gjykatës së Shkallës së I-rë nuk qëndrojnë, andaj kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar.

Me datë 04 shtator 2020, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-ë edhe një parashtrësë-plotësim të ankesës, në të cilën përsëri ai i përsëritë pretendimet e tija në ankesë dhe pohon se në bazë të nenit 369 të LMD-së është ndërprerë parashkrimi i kërkesës duke paraqitur padinë në gjykatë, andaj në këtë rast gabimisht është konstatuar gjendja faktike dhe gabimisht është zbatuar e drejta materiale, prandaj ai përsëri kërkon që kjo ankesë të aprovohet dhe të priset Aktgjykimi i ankimuar, të aprovohet padia si e bazuar apo çështja të kthehet përsëri në rigjykim.

Me datë 14 tetor 2020, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë përgjigjen në ankesë në të cilën ajo i kundërshton pretendimet ankimore dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo i ka paraqitur argumentet e saj në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 25 shkurt 2021, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-20-0202, ankesën e paditësit e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë dhe lëndën e kthen në rigjykim tek gjyqtari përkatës i Shkallës së I-rë. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se nuk e mbështetet konstatimi i Autoritetit të Likuidimit dhe as i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, se kërkesa e paditësit është parashkruar, pasi që nuk ka prova për të dhënë këtë konstatim. E paditura ishte e detyruar t'i dorëzojë paditësit 26,470 copë tullash makinerish, të cilat ishin paguar me faturat nr.76/94 të datës 28.07.1994 me urdhrin nr.000310 të datës 28.07.1994 dhe urdhrin e thesarit nr.1/112-B të datës 28.07.1994. Këto fakte të cilat ceken në Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.P.1468/95, të datës 06.12 1995, nuk janë kontestuar as nga përfaqësuesi i të paditurës i cili ka deklaruar se është e pa diskutueshme që paditësi ka paguar 26.470 copë tullash makinerish, dhe se ato nuk janë dorëzuar tek paditësi, për shkak të faktit se tullat nuk janë prodhuar. Kolegji i Apelit vëren se paditësi me qëllim të realizimit të kërkesës së tij, me datë 22.09.1995, e kishte dorëzuar një propozim në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë për lejimin e ekzekutimit, në bazë të dokumenteve të besueshme, i cili propozim ishte aprovuar dhe ishte lejuar ekzekutimi me Aktvendimin IV.IInr.1468/95 të datës 20.11.1995. Ndaj këtij Aktvendimi e paditura kishte paraqitur kundërshtim dhe pastaj procedura ka vazhduar në bazë të kërkesës e cila nga kjo gjykatë është trajtuar si padi. Në bazë të kësaj padie Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin IV.P.1468/95 të datës 06.12.1995, e shfuqizon vendimin për lejimin e ekzekutimit nr.26 93/95 të datës 05.10.1995 dhe e aprovon padinë e paditësit duke obliguar të paditurën t'i dorëzojë 26.470 copë tullash makinerish, të cilat ishin paguar nga

ana e paditësit. Ky Aktgjykim ishte ankimuar nga e paditura në Gjykatën e Lartë Tregtare në Beograd, mirëpo në dosje nuk ka dëshmi nëse ndonjëherë kjo gjykatë ka vendosur për këtë ankesë. Prandaj mund të konstatohet se Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike në Prishtinë IV.P 1468/98 i datës 06.12.1995, nuk është i formës së prerë dhe nuk ka as vullë të plotfuqishmërisë. Prandaj, në bazë të këtij Aktgjykimi paditësi ende nuk kishte mundësi të kërkojë përmbarimin e tij në procedurën përmbarimore, duke qenë se ai nuk ishte i formës së prerë. Kolegji i Apelit vëren se pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH NIN "Ramiz Sadiku" në P, me datë 04 shtator 2006 paditësi i drejtohet Autoritetit të Likuidimit, e cila kërkesë refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se ajo është parashkruar. Kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit ishte për kompensim në shumë prej 4.525,95 euro për 26.470 tullash makinerish të cilat ishin paguar nga paditësi, por që asnjëherë ato nuk janë dorëzuar nga e paditura tek paditësi. Nga ajo që u tha më lartë është shumë e qartë se paditësi ka marrë masa dhe veprime për të realizuar kërkesën e tij, duke filluar nga data 22 shtator 1995, kur ai e paraqiti kërkesën për lejimin e ekzekutimit në bazë të dokumenteve të besueshme, faturave të paguara, andaj është shumë e qartë që paditësi e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, dhe nuk mund të thuhet se kërkesa është parashkruar. Paditësi e kishte një Aktgjykim jo të formës së prerë që e njohu të drejtën e tij për kompensim dhe në bazë të këtij Aktgjykimi ai nuk kishte mundësi të fillojë procedurat e përmbarimit të tij, pasi që ai nuk ishte i formës së prerë. Andaj në këtë rast nuk mundet të aplikohet afati i parashkrimit të kërkesës i përcaktuar me nenin 379 të LMD-së, prej 10 vitesh dhe as ndonjë afat tjetër më i shkurtë i përcaktuar me këtë ligj. Kolegji i Apelit konsideron se pas ndërprerjes së parashkrimit që ka ndodhur me datë 28.02.1995, kur paditësi e paraqiti propozimin në gjykatë për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, i cili propozim pas kundërshtimit nga e paditura, nga kjo gjykatë u konsiderua si padi, më tutje në vazhdim nuk ka rrjedhë ndonjë afat i ri i parashkrimit për tu konsideruar se kërkesa e paditësit është parashkruar. Kjo për faktin se procedurat gjyqësore nuk ishin përfunduar lidhur me ankesën e të paditurës që ishte paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në

Prishtinë IV.P.1468/95 të datës 06.12.1995, dhe për mos përfundimin e këtyre procedurave nuk mund të mbahet përgjegjës paditësi.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, ajo regjistrohet me numrin e ri C-IV-21-0021.

Me datë 16 prill 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshon një urdhër për paditësin me të cilin kërkohet që të dorëzohen prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 06 maj 2021, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrit. Në këtë parashtresë paditësi i ka propozuar Gjykatës të caktojë një ekspert financiar për të kryer ekspertizën rreth valorizimit të borxhit të shprehur në valutën dinar, duke filluar nga data 28.07.1994 e deri në ditën e sotme, pasi që shuma e përcaktuar nga eksperti paraprak prej 4.525.95 euro është përlogaritur për borxhin bazë vetëm deri me datë 31.08.2006 e të cilën shumë edhe AKP-ja atëherë nuk e ka kontestuar fare. Në këtë parashtresë paditësi po ashtu ka kërkuar edhe kamatën në bazë të Mendimit juridik për kamatën të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës me datë 01.12.2020, që ndërlidhet me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes. Në këtë parashtresë përsëri ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e tij si e bazuar.

Në bazë të urdhrit të Shkallës së I-rë, eksperti financiar Sh J me datë 14.11.2022 e ka dorëzuar ekspertizën financiare lidhur me borxhin e pretenduar nga paditësi ndaj NSH-së, ndërsa me datë 30 janar 2023 i njëjti ekspert e ka dorëzuar plotësim ekspertizën financiare që ndërlidhet me kamatën ligjore në borxhin kryesor. Sipas plotësim ekspertizës financiare mendimi dhe konstatimi i ekspertit është se borxhi i pretenduar i paditësit është në shumë prej 1,949.84 euro, ndërsa kamata 194.98 euro, dhe të dyja janë në shumë prej 2,144.82 euro.

Me datë 06 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-21-0021, e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ017-0020 të datës 19 korrik 2013, dhe e obligon AKP-në që paditësit në emër të kompensimit për faturat e pa paguara, ti paguajë

shumën prej 1,949.84 euro, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore ti paguajë paditësit shumën prej 194.98 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me pikën II të dispozitivit po ashtu e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar, ndërsa me pikën IV të dispozitivit e obligon AKP-në që ti paguajë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 350.00 euro dhe të kompensoj pagesën e taksës gjyqësore prej 100.00 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës lidhur me shpenzimet refuzohet si e pa bazuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se në bazë të shkresave të dosjes është vërtetuar se paditësi me datë 22.09.1995 ka paraqitur kërkesë për përmbarrim të borxhit për kompensimin e 26.470 copë tulla të dorëzuara tek NSH-ja, bazuar në faturat e pa paguara. Propozimi për përmbarrim është konsideruar padi andaj Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin IV.br.1468/95 të datës 06.12.1995, e ka aprovuar padinë si të bazuar duke e detyruar të paditurën që ti dorëzojë 26.470 copë tulla makinerish dhe t'ia paguajë edhe shpenzimet në shumë prej 180.00 dinarë të atëhershëm. Kundër këtij Aktgjykimi NSH "Ramiz Sadiku" P kishte ushtruar ankesë, ndërsa nuk ka prova nëse ndonjëherë është vendosur lidhur me këtë ankesë nga Gjykata e Lartë Ekonomike në Beograd. Andaj bazuar në këtë gjendje faktike nuk mund të konsiderohet se ka ndodhur parashkrimi i kërkesës monetare prej 10 viteve siç pretendon e paditura. Fakti që Aktgjykimi nuk e ka vulën e plotfuqishmërisë dhe se pretendimi i paditurës se ky Aktgjykim nuk mund të provojë efekte juridike është pretendim i pa bazuar, pasi që paditësi do të fillonte procedurën përmbarrimore në bazë të këtij Aktgjykimi pa pasur nevojë të ushtronte ankesë në DHPGJS. Sa i përket lartësisë së kërkesës monetare të përcaktuar nga eksperti financiar, Gjykata është bazuar në konstatimet e dhëna në ekspertizën financiare edhe lidhur me borxhin kryesor edhe lidhur me kamatën, duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Me datë 07 prill 2023, AKP-ja përmes postës e ka dërguar një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-21-0021 të datës 06 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet

Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se bazuar në nenin 379 të LMD-së të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës parashkruhen për 10 vite. Në këtë rast paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa AKP-ja pohon se DHPGJS-ja ka juridiksion vetëm për të verifikuar ligjshmërinë e vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje në ankesë AKP-ja ka kërkuar që DHPGJS-ja të lëshohet edhe njëherë në shqyrtimin e çështjes në fjalë dhe ti marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 12 prill 2023, paditësi përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-21-0021 të datës 06 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet në tërësi padia si e bazuar, duke detyruar të paditurën të paguajë borxhin financiar në shumë prej 6.475.95 euro e përlogaritur me ekspertizën e dytë financiare të kryer nga "C" me ekspertin Q S nga P, të datës 13.06.2021. Për më tepër në ankesë paditësi i ka paraqitur të gjitha zhvillimet dhe rrjedhën procedurale të këtij kontesti gjyqësore deri në fazën e ankesës. Në ankesë ai konsideron se Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë e ka shkelur nenin 182.2 pika n) të LPK-së, pasi që ky Aktgjykim ka të meta, është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e Aktgjykimit, dhe se fare nuk janë treguar drejtë faktet vendimtare ose ato arsye që janë dhënë janë të paqarta e kontradiktore. Tutje paditësi konsideron se në bazë të nenit 183.1 të LPK-së Gjykata gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, përkatësisht nuk e ka vërtetuar faktin, origjinalin e ekspertizës të parë "C" të datës 31.08.2006, origjinalin e ekspertizës së dytë "C" të datës 13.06.2021, ekspertizën financiare të datës 14.11.2022 të kryer nga eksperti Sh J, plotësim ekspertizën financiare të datës 30.01.2023, të kryer nga eksperti Sh J si dhe shpenzimet procedurale të krijuara nga viti 1994 e deri me 06.03.2023. Paditësi konsideron se me Aktgjykimin e ankimuar është shkelur edhe neni 184 i LPK-së pasi që gabimisht është zbatuar e drejta materiale, e në

rastin konkret lidhur me borxhin themelor në shumë prej 4.500 dinarë përkatësisht të konvertuar në euro bazuar në ekspertizën e dytë financiare të kryer "C" me ekspertin Q S nga P, të datës 13.06.2021 shuma të cilën asnjëherë nuk është kontestuar nga pala e paditur si dhe shpenzimet procedurale që përcaktohen sipas dispozitave përkatëse të LPK-së, përkatësisht dëmi material që i është shkaktuar paditësit absolutisht pa fajin e tij.

Me datë 16 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 20 qershor 2023, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi përsëri i paraqet historinë dhe të gjitha zhvillimet procedurale lidhur me këtë kontest gjyqësor, të cekura edhe në ankesën e tij. Pas paraqitjes së këtyre zhvillimeve procedurale në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e AKP-së, pasi që është kontradiktore me çështjen e parashkrimit, gabimisht e interpreton plotfuqishmërinë e vendimeve gjyqësore, dhe atë në kundërshtim me LMD-në dhe me vet të drejtën juridike.

Arsyetimi ligjor:

Ankesat refuzohen si të pa bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa e paditësit është parashkruar, pasi që nuk ka prova për të dhënë këtë konstatim. Këtë konstatim Kolegji i Apelit e ka dhënë edhe në Aktvendimin e tij të parë AC-I-20-0202 të datës 25 shkurt 2021.

E paditura ishte e detyruar t'i dorëzojë paditësit 26,470 copë tullash makinerish, të cilat ishin paguar me faturat nr.76/94 të datës 28.07.1994 me urdhrin nr.000310 të datës 28.07.1994 dhe urdhrin e thesarit nr.1/112-B të datës 28.07.1994. Këto fakte të cilat ceken në Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.P.1468/95, të datës 06.12 1995, nuk janë kontestuar as nga përfaqësuesi i të paditurës i cili ka deklaruar se është e pa diskutueshme që paditësi ka paguar 26.470 copë tullash makinerish, dhe se ato nuk janë dorëzuar tek paditësi, për shkak të faktit se tullat nuk janë prodhuar.

Mund të konstatohet se Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike në Prishtinë IV.P 1468/98 i datës 06.12.1995, nuk është i formës së prerë, dhe se nuk ka as vullë të plotfuqishmërisë. Prandaj, në bazë të këtij Aktgjykimi paditësi ende nuk kishte mundësi të kërkojë përmbarimin e tij në procedurën përmbarimore, duke qenë se ai nuk ishte i formës së prerë. Mirëpo për kundër këtij fakti, paditësi nuk mund të atakohet me pasojën ligjore, pse Gjykata e Lartë Ekonomike në Beograd nuk ka vendosur lidhur me ankesën a NSH-së së paditur, apo nëse është vendosur ndonjëherë, pse ai nuk e ka edhe vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. Lëshimet e gjykatës nuk mund ti faturohen paditësit.

Faktet kontestuese në këtë rast janë vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, madje as AKP-ja si përfaqësuese ligjore e NSH-së së paditur, nuk ka mund të dorëzojë ndonjë provë që do ti kundërshtonte

pretendimet e paditësit lidhur me borxhin e kërkuar ndaj NSH-së. Ky borxh ka ekzistuar, ai nuk është kontestuar nga NSH-ja, dhe ai borxh është vërtetuar edhe me vendim gjyqësor.

Sa i përket lartësisë së borxhit të kërkuar nga paditësi, është fakt që ka pasur disa ekspertiza financiare për të valorizuar borxhin nga ish valuta në dinarë në valutën ekzistuese në euro.

Mirëpo paditësi në parashtresën e tij të datës 06 maj 2021, të dorëzuar në shkallën e I-rë, vet i kishte propozuar shkallës së I-rë të DHPGJS-së, të kryhet një ekspertizë financiare nga eksperti financiar për valorizimin e borxhit nga ish valuta në dinarë në valutën euro duke filluar nga data 28.07.1994 e deri në ditët e sotme.

Duke vepruar sipas kërkesë të paditësit, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me urdhrin e datës 16 shtator 2022, e cakton ekspertin Sh J të kryej ekspertizën financiare lidhur me borxhin e kërkuar nga paditësi.

Duke u bazuar në këtë urdhër, eksperti financiar Sh J me datë 14 nëntor 2022 e dorëzon ekspertizën financiare, ndërsa me datë 30 janar 2023 edhe plotësim ekspertizën financiare. Mendimi dhe konstatimi i ekspertit në këto dy ekspertiza është se borxhi kryesor duhet të jetë në shumë prej 1,949.84 euro, ndërsa interesi ligjor në shumë prej 194.98 euro.

Andaj duke u bazuar në këtë ekspertizë financiare, që në fakt ishte kërkuar nga vet paditësi, Shkalla e I-rë me të drejtë nuk i ka marrë në konsideratë ekspertizat tjera paraprake financiare, por e ka aprovuar kërkesën për borxh duke u bazuar në ekspertizën e fundit në shumë prej 1.994.84 euro në emër të borxhit kryesor, dhe në shumë prej 194.98 euro në emër të interesit ligjor. Nuk ka asnjë bazë dhe arsye që të mos i besohet ekspertizës së fundit, të kryer nga eksperti i licensuar financiar.

Kolegji i Apelit konstaton se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me të drejtë ka vepruar duke aprovuar pjesërisht ankesën e paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke ndryshuar këtë vendim që nuk kishte bazë ligjore të qëndrojnë, dhe duke e aprovuar pjesërisht edhe shpenzimet procedurale për ekspertizën e kryer si dhe kompensimin e taksës gjyqësore të paguar në Shkallën e I-rë prej 100 euro. Me të drejtë është vendosur që të gjitha këto shuma duhet të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj të dy ankesat refuzohen si të pa bazuara dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesit tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 02 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, dhe me datë 06 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë në Kolegjin e Apelit me datë 21 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
